



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .11.2024

**MBLEDHJA Nr. 48,**  
**Datë 25.11.2024, ora 13:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 25.11.2024, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 48 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestionimi ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe procedurat rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri - Kosovë.
2. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionimeve.
3. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të propozuar nga OST sh.a.
4. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**